



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 31.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi në parim dhe nen për nen i projektligjit “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”
2. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Eglantina Gjermeni, Evis Kushi, Andrea Marto, Ervin Bushati, Adnor Shameti, Vasilika Hysi, Rudina Hajdari, Klotilda Bushka, Ilir Xhakolli dhe Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Klajda Gjoshaj, Nard Ndoka, Tritan Shehu, Edi Paloka, Klevis Balliu, Edmond Panariti

Të ftuar:

Pandeli Majko - Ministër i Shtetit për Diasporën

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme. Sot në rendin e ditës kemi diskutimin e projektligjit “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Mendoj që ligjin ta diskutojmë në parim dhe nën për nën brenda së njëjtës mbledhje të komisionit. Kemi relatorin, i cili do ta marrë fjalën menjëherë.

Dua të keni parasysh se gjatë diskutimit nën për nën do të diskutojmë të gjitha vlerësimet dhe sugjerimet që ka dhënë Komisioni i Ekonomisë, si komision për dhënien mendimi. Besoj se biem të gjitha dakord që në fillim, në parim se do t’i përmbahemi mundësisht çdo propozimi të ardhur nga qeveria apo nga komisioni, pa shtuar dhe hequr gjëra thelbësore, që do të rregullojnë Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, i cili është një fond që do të krijohet nga e para.

Urdhëroni, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Ky projektligj ka si objekt rregullimin e formës organizative dhe parashikimin e çështjeve parimore të funksionimit të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Gjithmonë e më shumë qeveritë e shteteve të ndryshme janë duke përfshirë në programet e tyre objektiva strategjike për diasporën dhe po njohin me rolin që kjo e fundit mund të luajë për zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe origjinës, edhe pa qenë e nevojshme për t’u kthyer në atdhe. Gjithashtu, një sërë nismash, edhe në nivel evropian, janë dëshmi e qartë se diaspora është edhe në fokus të axhendës europiane.

Kuadri ligjor për investimet nuk e identifikon diasporën si një rast i veçantë, pasi nuk e dallon atë nga investitorët e tjerë. Është e vërtetë se shteti nuk duhet ta dallojë diasporën e biznesit bazuar në përkatësinë e saj etnike, por nga ana tjetër nuk mund të lërë jashtë vëmendjes rolin e saj specifik zhvillimor. Njohja dhe mbështjellja e këtij roli, nëpërmjet këtij projektligji jo vetëm në drejtim të investimeve dhe menaxhimit të tyre, por edhe në drejtim të orientimit filantropik në Shqipëri dhe jashtë saj, përbën bazën për një fond zhvillimi me më shumë vlerë të shtuar.

Projektligji “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës” synon zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese, dhënien e kontributit për promovimin e mirëqenies së zhvillimit social ekonomik, komunitetit dhe promovimin e pjesëmarrjes së diasporës në jetën e vendit të origjinës, si dhe qasjen, rëndësinë që ka diaspora në ndërtimin e urave lidhëse me vendin e

originës. konkretisht në fushat përkatëse dhe në fushat e zhvillimit social, ekonomik, politik dhe kulturor të vendit të originës.

Dua të përmend disa nga risitë e projektligjit, i cili në vetvete përmban disa risi| si: ngritjen e strukturave apo organeve e drejtuese të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, përcaktimin e kapitaleve dhe burimeve financiare, ku do të mbështetet në aktivitetin e saj Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës, si dhe përcaktimin e misionit dhe objektit e veprimtarisë së këtij fondi.

Për sa u përket efekteve financiare, është e rëndësishme të theksoj se fondi në vitin e parë të krijimit do të financohet nga buxheti i shtetit, me qëllim mbulimin e veprimtarisë administrative, ku përfshihen zërat kryesorë të shpenzimeve administrative: si paga, sigurime, shpenzime e të tjera dhe fondi mbështetet nga buxheti i shtetit për vitin 2018 me një fond total prej 50 milionë lekësh. Godinat dhe pajisjet kompjuterike sigurohen sërish nga shteti.

Lidhur me Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, ky ligj përcakton misionin dhe rolin e tij në orientimin dhe ngritjen e pikave filantropike, donacioneve dhe investimeve të vendeve anëtare të diasporës në drejtim të zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor brenda dhe jashtë vendit. Ky ligj përcakton se rregullat për veprimtarinë, organizimin dhe funksionimin e këtij fondi miratohen me ligj të veçantë.

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Prandaj, në këto kushte ftoj deputetët ta miratojmë në parim dhe nen për nen projektligjin.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – A keni pyetje?

Kam unë pyetje për ministrin.

Për aq sa unë e kam lexuar ligjin, më duket jo fort mirë e përcaktuar, nga mënyra se si është shkruar, fakti se kush do të paguajë çfarë, sepse në dijeninë time dhe në informacionin që unë kam, buxheti i shtetit do të jetë i disponueshëm për shumën x, pavarësisht se cila është shuma vetëm në vitin e parë të krijimit të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, më pas e gjitha do të jetë e bazuar mbi donacion. Jam e saktë në këtë që them, zoti Ministër? Nuk ka disponibilitet tjetër, për aq sa unë jam e informuar nga Ministria e Financave.

Pandeli Majko – Kjo është një çështje që u diskutua edhe në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave. Unë ua shpjegova edhe kolegëve atje, edhe në diskutimet konfidenciale, edhe në komision, logjika ka qenë se ky projektligj është paraqitur në një paketë së bashku me ligjin për diasporën, në një kohë që sapo kishte kaluar ligji AKD-së, nuk

kishte kaluar akoma strategjia kombëtare e diasporës, që unë kam dërguar së bashku me planin e veprimit. Kishte disa ambiguitete siç është edhe rasti, si do të jetë marrëdhënia e Fondit të Zhvillimit me institucionet e tjera.

Mimi Kodheli – Ju lutem, a mund ta dëgjojmë ministrin?!

Pandeli Majko – Edhe në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave u tha qartazi se kjo çështje nga mënyra se si është komoduuar ka një ambiguitet, duhet thënë se FSHZHD-ja është person juridik publik. Pra, do të hiqet shprehja që të financohet vetë, sepse, së pari, është një institucion shtetëror, duhet të garantohet vazhdimësia, duhet të ketë një marrëdhënie shumë të qartë. Kjo është përcaktuar si e tillë edhe në ligjin kuadër të diasporës, kështu që edhe neni për fondin e vitit të parë nuk do të propozohet që të hiqet, por do të jetë një institucion normal si të gjitha institucionet e tjera shtetërore. Një propozimi i tillë ju ka ardhur edhe nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Mimi Kodheli – Unë po i shikoj propozimet që kanë ardhur për nenet 4 dhe 7, për pikat respektive. Pra, do të jetë një fond, i cili do të financohet nga buxheti i shtetit?

Pandeli Majko – Domethënë, do të jetë buxhetor, por do të menaxhojë edhe projektet, donacionet, filantropitë. Sigurisht që të gjitha këto do të jenë të rregulluara ose sipas neneve të këtij ligji, ose me vendim të posaçëm të qeverisë.

Mimi Kodheli – Mirë, dakord. Besoj se ju i keni përpara vlerësimet e komisionit. Pastaj, kur të kalojmë në diskutimin nen për nen...

Pandeli Majko – Ky diskutim është bërë në Komisionin e Ekonomisë dhe në prani të përfaqësuesve të Ministrisë së Financave

Mimi Kodheli – Në rregull. Ata kanë sjellë sugjerimet e tyre nen për nen, kështu që do t'i kalojmë nen për nen...

Unë kam edhe një pyetje tjetër. Flitet për bonon e biznesit të diasporës. Unë di që dhomat e biznesit dhe tregtisë janë struktura të cilat, së pari, bazohen në ngritjen vullnetare të tyre, pra nuk është një marrëdhënie që rregullohet me ligj. Ka një ligj që mirëpërcakton Dhomën Shqiptare të Tregtisë, që do thotë se ose kjo dhomë e biznesit të diasporës do të jetë pjesë e atij ligji, ose nuk do të jetë pjesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po pyes: Dhoma e Biznesit të Diasporës...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Së pari, zoti Ministër, në ligj, në draftin që është sjellë nuk është përmendur...

Klotilda Bushka – E ka propozuar Ekonomia.

Pandeli Majko – Është diskutuar edhe në Komisionin e Ekonomisë. Pak a shumë, do të ketë një marrëdhënie midis institucioneve shtetërore dhe organizimeve të diasporës. Për shembull, agjencia ka një korrelacion, që është shkruar edhe në ligj, me këshillin koordinues të diasporës, që ka përfaqësues nga Këshilli i Ministrave.

Për sa i përket fondit, ne diskutuam dhe ramë dakord me Komisionin e Ekonomisë që fondi i zhvillimit të ndihmojë në krijimin dhe organizimin e dhomës së diasporës, por pa thënë se si do të jetë dhoma, çfarë do të bëjë dhoma, por vetëm duke u bazuar në legjislacion.

Jemi ulur së bashku me përfaqësuesit e Kosovës dhe të Maqedonisë, që, për fat të mirë, janë shqiptarë, dhe ekziston një rrjet diaspore, i cili është në sistem në nivelin NGO-së.

Mimi Kodheli – Mbi bazën e të ardhurave, ato mund të organizohen si institucione.

Pandeli Majko – Ne duam që të bëjmë tri dhoma diaspore: një në Shqipëri, një në Kosovë dhe një në Maqedoni. Ideja është që në Shqipëri do të ndihmohet në fazën fillestare nga fondi, kaq.

Mimi Kodheli – Nuk do të jetë e sanksionuar në ligj.

Pandeli Majko – Jo, do të jetë neni 16, që është kalimtar: “Fondi ndihmon organizimin e Dhomës së Diasporës Shqiptare”.

Mimi Kodheli – Pse duhet të jetë në ligj? Fondi mund ta bëjë këtë me...

Pandeli Majko – Ta lëmë me logjikën e detyrave, që e ndihmon.

Mimi Kodheli – Nuk mund të jetë në ligj, sepse ndihma bëhet e detyrueshme. Po sikur të mos e ndihmojë fondi?

Pandeli Majko – Do ta ndihmojë, sepse, normalisht, shteti ka shumë nevojë për një gjë të tillë.

Mimi Kodheli – Shteti ka nevojë, por shteti ka ligje. Ka një dhomë tregtie të rregulluar me ligj të veçantë dhe të gjitha dhomat e tjera janë mbi baza vullnetare, pra dhoma ose do të jetë pjesë e këtij ligji të integruar, ose, në qoftë se fondi do të ndihmojë nesër krijimin e një dhome, dhoma do të krijohet mbi baza vullnetare, nën modelin e Kosovës dhe Maqedonisë, pra të tria bashkë. Mund të ketë një vendim të Këshillit të Ministrave që thotë se do ta ndihmojmë në këtë moment fondin. As VKM-në nuk shikoj, ligjin jo e jo. Ligji ka sanksione detyrues, pra të detyron. Unë nuk mendoj se duhet ta ndihmoj fondin. Unë nuk mund ta detyroj të ndihmojë fondin, se ndërkohë ndërhyj në një ligj tjetër, pra bie ndesh me ligjin e “Për dhomat e tregtisë në Republikën e Shqipërisë”.

Pandeli Majko – Te neni 2 “Misioni”, ne, midis të tjerave, kemi thënë: “Inkurajimi i orientimit të prirjeve të investimeve të diasporës në mbështetje të zhvillimit të Republikës së Shqipërisë”. Domethënë, organizimi i dhomës së diasporës është substancial. Kini parasysh

së do të kemi shumë njerëz, të cilët për shumë arsye nuk i janë ofruar Shqipërisë. Është një pasuri e jashtëzakonshme.

Mimi Kodheli – Le të jenë pjesë e Dhomës Shqiptare të Tregtisë.

Pandeli Majko – Nuk vijnë, se do të kishin ardhur....

Mimi Kodheli – Fondi shqiptar, zoti Ministër, të bëjë punën e tij që këta të vijnë te Dhoma Shqiptare e Tregtisë.

Pandeli Majko – Më dëgjoni, ju lutem! Ata do ta ndërtojnë këtë, sepse, po të ishte ashtu, ata nuk do ta kishin krijuar rrjetin e biznesit...

Mimi Kodheli – Ke konflikt në sistemin ligjor...

Klotilda Bushka – Nuk është fare në draft kjo që po diskutojmë. Është një propozim që ka bërë Komisioni i Ekonomisë...

Mimi Kodheli – Po, pra, por unë pyetje po i bëj. A e keni mendjen që, kur të shkojmë te neni, ta bëjmë këtë gjë, apo jo?

Pandeli Majko – Është një nen transitor.

Klotilda Bushka – Kur nuk e ka sjellë ministri, por është propozim i Komisionit të Ekonomisë.

Mimi Kodheli – Po, propozimi i Ekonomisë nuk ka dalë nga Komisioni i Ekonomisë, Klotilda.

Klotilda Bushka – Nga Ekonomia ka dalë...

Mimi Kodheli – Ka dalë me kërkesë të atyre që e kanë sjellë. Nuk ka dalë si nevojë nga Komisioni i Ekonomisë, por është kërkuar...

Klotilda Bushka – Mirë pra, atëherë ne si anëtarë të komisionit nuk na e keni dhënë këtë informacion. Ajo që shohim është se drafti i ministrisë është ndryshe dhe propozimi është nga komisioni.

Pandeli Majko – Na e ka kërkuar rrjeti...

Mimi Kodheli – Patjetër, të mbarojmë diskutimin me ministrin, pastaj vazhdo ti me diskutimin tënd. Ju pyeta nëse keni pyetje dhe diskutime, pastaj vazhdojmë me diskutimet dhe pyetjet në parim. Në diskutimet në parim mund të diskutohet edhe për gjëra që kanë të bëjnë me ne tek e tek, pastaj, kur të shkojmë te neni, e diskutojmë më thellësisht këtë gjë.

Pandeli Majko– Rrjeti i bizneseve të diasporës e ka marrë vendimin...

Mimi Kodheli – Shumë bukur, aq më mirë, por kjo nuk mund të sanksionohet në ligj.

Ervin Bushati – Më fal që po ndërhyj, por dua të di, a është diskutuar kjo me Dhomën Tregtare këtu?

Pandeli Majko – Legjislacioni ynë nuk i ka dhënë Dhomës Tregtare veton për të lejuar ose jo krijimin e dhomave të tjera. Ekziston një rrjet i bizneseve të diasporës...

Ervin Bushati – Po të mos ketë transparencë në këtë gjë, mund të kalojë në një konflikt tjetër në të ardhmen

Pandeli Majko- Çfarë konflikti?

Ervin Bushati – Nuk i dihet.

Mimi Kodheli – Zoti Bushati, si ekonomist që je, a keni ndonjë koment për të bërë?

Ervin Bushati – Unë e shoh si bashkëpunim, jo si komplementar. Ligji ka një sërë biznesesh që janë të organizuara, sidomos ata të Kosovës janë shumë më mirë të organizuar sesa shqiptarët.

Në Munihi takova disa përfaqësues të Dhomës Tregtare të Kosovës, kishin shumë...

Mimi Kodheli – E krijojnë bazuar në ligjet e vendeve atje?

Pandeli Majko – Patjetër dhe funksionojnë më shumë...

Ervin Bushati – Nuk do të quhet degë e kësaj.

Mimi Kodheli -Thashë se mos e krijojnë këtu, sepse nuk po e kuptoj mirë.

Ervin Bushati – Nuk po them të krijohet këtu, po flas në parim. Unë mendoj se është një potencial dhe një kapital shumë i madh që duhet shfrytëzuar, jo vetëm për arsye ekonomike, që nesër mund të kenë për të investuar këtu, por edhe një arsye krenarie kombëtare dhe më e rëndësishmja është se ata janë votues në vendet ku ata ndodhen dhe votat e tyre ndikojnë shumë në parlamentet apo zgjedhjet lokale dhe kjo na jep edhe në një levë. Si mund të kanalizohet kjo, kur këta janë juristë?

Mimi Kodheli – Pra, nëse e kam kuptuar drejt, bizneset e diasporës jashtë kufijve të Shqipërisë mund të organizohen bazuar në ligjin e atij vendit atje. Fondi Shqiptar mund t'i ndihmojë që ata të krijohen atje, por, në qoftë se e ne e bëjmë ligjin...

Ervin Bushati – T'i koordinojmë në mënyrë federative.

Mimi Kodheli – Po, është fjala e duhur “të koordinohen në mënyrë federative”, por ta vendosë në ligj që ai mund të krijohet, kur ai do të krijohet duke u bazuar në ligjin e vendit respektiv... Që ai e ndihmon, se e ka në mision është një gjë, nëse unë e vë nën të veçantë në ligj...

Ervin Bushati – Nuk i di se si janë traktatet ndërkombëtare në këtë pikë, por juristët mund të na ndihmojnë. Tani, që ne të imponohemi...

Pandeli Majko – Nuk po diskutojmë që fondin të ndihmojë dhomën e biznesit në Gjermani, e kam kërkuar për në Tiranë.

Ervin Bushati – Unë e di që shqiptarët kanë bërë një dhomë në Gjermani. Ata erdhën vitin e kaluar në komision dhe patëm një takim shumë të vrullshëm...

Mimi Kodheli – Unë kam dyshimet e mia, megjithatë, duke lexuar komentet e Komisionit të Ekonomisë, do të diskutojmë edhe një herë lidhur me nenin respektiv.

Pandeli Majko – Kush është relator te Komisioni i Ekonomisë?

Mimi Kodheli – Profesor Anastas Angjeli.

Në qoftë se nuk ka komente të tjera, kalojmë në miratimin e projektligjit në parim. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet projektligji në parim.

Kalojmë në diskutimin nen për nen.

Në nenin 1, tek objekti ka një koment. Po lexoj si është dizenuar nga qeveria dhe çfarë komenti bën...

Pandeli Majko- Ne jemi dakord me të gjitha, mos u shqetëso.

Mimi Kodheli- Dakord, por po e lexoj për efekt regjistrimi.

Neni 1, “Objekti”: “Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për veprimtarinë, organizimin dhe funksionimin e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës” riformulohet si më poshtë: “Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Pra, është hequr vetëm fjala “veprimtari”. Moza, a e kam të saktë?

Mimoza Arbi – Po.

Pandeli Majko – Është bërë një rregullim.

Mimi Kodheli – Neni 1. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 2. Nuk po e lexoj të gjithë nenin, por ka vetëm një ndryshim, në qoftë se nuk gaboj, ku thuhet se misioni ka qenë në strategjitë e caktuara si prioritare për diasporën dhe bëhet bazuar në Strategjinë Kombëtare për Diasporën, për diasporën si edhe brenda vendit është hequr, ndërkohë është bërë: “...bazuar në Strategjinë Kombëtare për Diasporën nëpërmjet promovimit, inkurajimit dhe orientimit të prirjeve filantropike dhe investimeve të diasporës në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.”

Pra, jemi dakord që strategjia të jetë e përcaktuar duke hequr fjalët “të përcaktuara si prioritare”, si dhe: “brenda vendit”. Jemi dakord me riformulimin e neni 2 të projektligjit?

Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Besoj se nuk kemi arritur akoma te komentet e neneve të komisionit, por neni 3 ka rregullime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj së lexuari. Apo keni ndonjë koment para se ta fillojmë?

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për nenin 3, për termin “donator”, që është përdorur dhe për termin “donacion”. A është vlerësuar nëse është përdorur terminologjia që përdoret në ligjet që rregullojnë grantet, mënyrat e buxhetimit, burimet e të ardhurave?

Adnor Shameti – Është e njëjta terminologji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – T’i marrim përkufizimet me radhë.

Mimoza Arbi - Vetëm ky ndryshim është dhe ska përkufizime të tjera të ndryshuara.

Mimi Kodheli - Pra, FSHZHD-ja ka të njëjtin përkufizim, edhe statuti ka të njëjtin përkufizim, edhe manuali i procedurave ka të njëjtin përkufizim, edhe projekti ka të njëjtin përkufizim, edhe donatorët kanë të njëjtin përkufizim, edhe filantropi ka të njëjtin përkufizim.

Vetëm te donacionet përkufizimi bëhet nga: “Donacione”, të ardhura për përmbushjen e misionit e të projekteve të realizuara nga FSHZHD-ja, nga fonde brenda dhe jashtë vendit”, në: “Donacione”, është ofrimi i fondeve, financimeve ose bazës materiale përmes një kontrate ose marrëveshjeje për të mbështetur përmbushjen e misionit të projekteve të realizuara nga FSHZHD-ja.”

Ky, për të cilin flet zonja Hysi, është pikërisht përkufizimi që ofron legjislacioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

FZSHH-ja e ka kështu, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Vasilika Hysi – Kisha edhe diçka para se ta miratojmë. Rregulli i teknikës legjislative kërkon që përkufizimet të vendosen sipas rendit alfabetik. Duhet marrë parasysh edhe kjo.

Mimi Kodheli – Dakord.

Të shënohet edhe kjo vërejtje.

Kush është dakord me nenin 3 me riformulimin, si më poshtë dhe me komentet e zonjës Hysi?

Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4, “Statusi juridik”. Ka disa komente në lidhje me këtë nen.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat sugjeron që pika 1 e nenit 4, të riformulohet si më poshtë: “FSHZHD-ja është person juridik publik.”

Në kllapa thuhet, se në këtë pikë sugjerohet të shtohet fjala “jobuxhetor”. Merret në konsideratë fakti që fondi do të funksionojë si një institucion i pavarur financiarisht. Ky është propozimi që vjen nga këshilltarët e komisionit, në një kohë që propozimi i Komisionit për Ekonominë dhe Financat për pikën 1 ishte si më sipër dhe të shtohet fjala “jobuxhetor”.

Elona Hoxha - Faleminderit, kryetare!

Më duket se kjo ka një konflikt me nenin 7, “Kapitali dhe burimet e financimit”. Aty thuhet:

1. Të ardhurat në buxhetin e FSHZHD-së krijohen nga:

a) fondet e përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, dhe donatorëve të ndryshëm për financimin e projekteve të zbatuara nga FSHZHD-ja;

b) fondet nga buxheti i shtetit; ...”, pra bie sugjerimi që të shtohet fjala “jobuxhetor”.

Mimi Kodheli – Te neni 7, pika “b” i projektligjit një nga burimet ka qenë fondet nga buxheti i shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, në vlerësimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, për nenin 7 , pika “b” (po ju lexoj atë që ka sjellë Erion Braçe), është: “b) fondet nga buxheti i shtetit për projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 6, pika 4, të këtij ligji”.

Tani të lexojmë pikën 4 të nenit 6!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj, të lutem, se nuk e kam mbaruar fjalinë!...

Në pikën 4 të nenit 6 thuhet: “Në menaxhimin e projekteve të financuara nga Këshilli i Ministrave dhe/ose donatorë. Në përputhje me objektin e veprimtarisë së këtij të fundit, Këshilli i Ministrave mund të kontrakttojë me FSHD-në sipas marrëveshjeve përkatëse”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Ideja është se vetëm këtu merr lekë nga buxheti.

Mimi Kodheli – Pra, i merr nga Këshilli i Ministrave, sipas projekteve të financuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, germa “b” do të ndryshohet në nenin 7, që do të thotë e afekton pikën 1 të nenit

4?

Zonja Hysi?

Vasilika Hysi – Unë do të thosha që kur krijohet një institucion, person juridik, publik ose privat, statusi duhet të përcaktojë, çfarë është paragrafi i parë; i dyti, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit, së treti, ku ka selinë.

E katërta, do të ketë lekë.

Për këtë nen jam e mendimit që në paragrafin e parë të thuhet se është person juridik publik jobuxhetor; në paragrafin e dytë që gëzon pavarësi drejtuese, teknike e të tjerë, si dhe e ushtron veprimtarinë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me statusin, manualin e procedurave dhe kushteve të përcaktuara në marrëveshje, ndërsa pika 3 duhet të riformulohet, ku do të themi se Fondi e ka selinë në Tiranë.

Çështja që do të diskutohet, sepse nuk është pasqyruar diskutimi që bëmë dje, është: a ka të drejtë të krijojë filiale, apo jo? Kjo është një çështje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne thamë jo.

Unë fola dje me propozuesin dhe thamë jo.

Mimi Kodheli – Zonja Hysi, kjo është një gjë e rëndësishme, por nuk do të kalojmë te setet dhe filiale, pa bërë ndryshimet respektive lidhur me financimin, që është një gjë shumë e rëndësishme.

Pra, unë jam dakord me zonjën Hysi kur thotë se pika 1, në statusin juridik të jetë: “Fondi është një person juridik publik”, pikë.

Vasilika Hysi – Jobuxhetor.

Mimi Kodheli – Jobuxhetor.

Vasilika Hysi – Do të marrësh buxhet edhe nga qeveria, apo do të...?

Mimi Kodheli – Me projekte.

Evis Kushi – Vetëm vitin e parë, më duket.

Mimi Kodheli – Jo.

Vasilika Hysi – Vetëm kështu, e thotë më poshtë.

Mimi Kodheli – Tani, ky thotë, të paktën si e kuptoj unë: “person juridik publik”, ndërkohë, më mbrapa, as jobuxhetor, as financohet. Më tej do të sqarojmë nëse e ka me projekte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, si do t’i tërheqë. Biem dakord kështu?

Klotilda Bushka – Dakord.

Mimi Kodheli – Zonja Hysi?

Vasilika Hysi – Shprehem dakord.

Mimi Kodheli – Juristë? Profesorë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pandeli Majko – Shprehem dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Juristët pyes.

Vasilika Hysi – Zonja kryetare, ne nuk pranojmë propozimin që ka bërë Komisioni i Ekonomisë.

Pandeli Majko – E ka bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Jo, ka thënë të sugjerohet shprehja “jobuxhetor”.

Pandeli Majko – Komisioni e ka sjellë kështu: “person juridik, publik”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – E keni shtuar ju? Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Kush e ka sugjeruar? Ju, apo Komisioni i Ekonomisë?

Mimi Kodheli – Komisioni i Ekonomisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne do ta lëmë pikë.

Tani, në diskutimin me Ministrinë e Financave, që të jemi *fair* me këtë gjë, Ministria e Financave është shprehur: “Nuk jap asnjë kokërr leku për Fondin; nuk ka!”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, vetëm për projektet në bazë të një marrëveshjeje, që Këshilli i Ministrave bën me Fondin në raste të veçanta për projekte të veçanta.

Klotilda Bushka – Atëherë, e lëmë pikë dhe, sipas rastit, te neni tjetër.

Pandeli Majko – Shikoni, në çdo rast, ju e dini shumë mirë edhe numrin e personelit e të gjitha, kalojnë nga filtri i Ministrisë së Financave dhe i gjithë fleksibiliteti do të jetë...

Mimi Kodheli – Nejse, parashikimi në buxhet, është parashikimi në buxhet.

Pandeli Majko – Tani, ne nuk mund ta krijojmë Fondin e Zhvillimit si një NGO.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Jam dakord.

Mimi Kodheli – Prandaj edhe Ministria e Financave ka thënë: “Po, vitin e parë, sa të krijohet, sa të merrni kompjuterët, ndërtesën”.

Pandeli Majko – Nuk e bëjnë dot.

Mimi Kodheli – Pastaj zgjidhe vetë.

Pandeli Majko – Nuk e bëjnë dot kështu.

Mimi Kodheli – Si mbahet? Atëherë, mos e bëj.

Klotilda Bushka – Të paktën pagat do t'i shohësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pandeli Majko – Çfarë investimesh që do të marrësh, do ta bësh. Jam dakord aty, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Nuk e kanë as palët PBB-në, e mban mend çfarë të kam thënë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me sa kuptova unë, në qoftë se Arben Ahmetaj është ende ministër, as paga nuk ka për të të dhënë, do të të lërë në tako...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Aktualisht sot që flasim, ka buxhet për këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Nuk ka, jo.

Pandeli Majko – Unë nuk po kërkoj që ta fillojmë nesër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe në strategji e ka kaluar.

Mimi Kodheli – Atëherë, dua të vëmendjen tuaj, kolegë: “FSHZHD-ja është person juridik publik”; *full stop*. Bini dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Pra, biem dakord me pikën 1 të nenit 4.

“FSHZHD-ja gëzon pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike”. Pse duhet thënë që gëzon pavarësi drejtuese e financiare? Në qoftë se do edhe paratë e shtetit, nuk e gëzon këtë pavarësi.

Pse “financiare”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, por tani ke edhe donacione, edhe paratë e shtetit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po fute paratë e shtetit, nuk gëzon dot pavarësi financiare.

Klotilda Bushka – Kjo ka të bëjë me menaxhimin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Ndryshojnë rregullat e lojës pastaj.

Vasilika?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Po, është ndryshe nga biseda që bëmë dje paradite.

Mimi Kodheli – Jo, jo, më thoni si e keni bisedën. Unë jam e hapur...

Vasilika Hysi – Në qoftë se do të merren fonde nga shteti, do të raportojë dhe do të kontrollohet nga KLSH-ja e nga të gjitha.

Mimi Kodheli – Nuk ka pavarësi.

Klotilda Bushka – Do t'u nënshtrohet rregullave...

Mimi Kodheli – Të gjithave.

Vasilika Hysi – Të gjithave. Ja ku i kemi ekonomistët.

Pandeli Majko – Do ta shikoni në nenet e mëpasshme.

Do të japin informacion, do të zgjidhen nga Këshilli i Ministrave, të gjitha.

Vasilika Hysi – Patjetër, se ka rregulla për menaxhimin e fondeve.

Pandeli Majko – Absolutisht po.

Mimi Kodheli – Të jepet informacion.

Evis Kushi – Që në buxhet do të jesh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Pra: “Gëzon pavarësi drejtuese, administrative, teknike”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika, më thuaj, si do ta lëmë?

Vasilika Hysi – Jo, jo, ja ku kemi ekonomistët!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Vasilika, *I trust you*, më thuaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, më pas, se është neni këtu.

Neni kështu thotë: kaq. Si t'i thuash që neni atje...? Neni atje jo, vjen ky, pa vjen ai!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si e ka Fondi Shqiptar i Zhvillimit?

Evis Kushi – Është i pavarur, pra ka një pavarësi në menaxhimin...

Vasilika Hysi – A merr fonde nga qeveria?

Mimi Kodheli – Merr me kontratë, me marrëveshje.

Vasilika Hysi – Ekzakt, vetëm me kontratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Pra, në qoftë se ne marrim statusin juridik të FSHZH-së, është *mot à mot* si këtu: gëzon pavarësi administrative, teknike, financiare?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Evis Kushi– Po, më duket se kanë pavarësi.

Mimi Kodheli – Financiare?

Klotilda Bushka – Tani, a t’ju them një gjë nga ligji?

Si rregull, edhe sikur një OJF nga OSHC-ja të marrë para që është OJF normale, që aplikon te kjo agjencia, e cila jep para për shoqërinë civile, edhe paratë që merr nga ajo OJF ka detyrimin t’i kontrollojë Kontrolli i Lartë i Shtetit. Kështu që si i merr lekët ti direk nga buxheti i shtetit, se je pjesë e ligjit “Për buxhetin” apo me marrëveshje, patjetër detyrimet që mund të kontrollosh dhe që do të kontrollohesh...

Mimi Kodheli - Nuk po flasim për kontrole, po flasim për pavarësi financiare, që janë dy gjëra të ndryshme.

Klotilda Bushka- Të nisemi nga kontrolli që të arrijmë te pavarësia. Pra, si një ent publik që e konsideruam tani, FSHZHD-në, ky si ent, person juridik publik gëzon autonomi juridike më vetë, që do të thotë se merr vendime vetë. Ka pavarësi organizative, sepse emëron dhe shkarkon stafin e vet. Ka pavarësi menaxheriale ku përfshihen edhe financat, paratë, pavarësisht se nga i merr, vetë i menaxhon, nuk i merr firmën dikujt si t’i ndajë në zëra. Fjala e pavarësisë funksionale që përfshin edhe financat është brenda, puna është se ne duam të arrijmë qëllimin që ta ndajmë: paratë që marrin këta, do t’i menaxhojnë vetë apo do t’i menaxhojnë sipas rregullave të menaxhimit të buxhetit të shtetit? Ta ndajmë këtu dhe të rregullojmë fjalën “pavarësi”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë do t’i menaxhoj vetë, do të vendos zërat, do harxhoj kaq për këtë, kaq për atë, do të kem buxhetin tim, apo do ta bëj me thesarin e shtetit?

Mimi Kodheli- Të dëgjojmë ministrin!

Pandeli Majko- Keni një ndërhyrje nga Komisioni i Ekonomisë. “FSHZHD-ja përdor të ardhurat e krijuara për financimin e veprimtarive të veta sipas legjislacionit në fuqi të menaxhimit financiar”.

FSHZHD-ja zbaton të gjitha rrugët e legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, rregullat dhe procedurat e hollësishme për administrimin dhe përdorimi i të ardhurave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Vasilika Hysi - Zoti ministër, te cili nen?

Pandeli Majko - Te neni 7.

Mimi Kodheli - Cili ishte opsioni?

Pandeli Majko – Nuk kishte ndonjë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adnor Shameti - Unë vlerësoj që referencat e Komisionit të Ekonomisë duhet t'i marrim parasysh të gjitha *mot a mot*. Të mos i hyjmë analizës, se është më e plotë në atë formë. Sugjeroj që t'i kalojmë në bllok ashtu siç janë paraqitur.

Klotilda Bushka- Kemi mbetur te fjala “pavarësi”.

Vasilika Hysi - Ajo është e rëndësishme, te paragrafi i tretë, ka përsëritje, duhet të themi: “Fondi e ka selinë në Tiranë”.

Pandeli Majko - Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi - Ka përsëritje. “Fondi e ka selinë në Tiranë” është pikë më vete.

Mimi Kodheli – Kam një pyetje: pse duhet të jetë në ligj se ku e ka selinë?

Vasilika Hysi - E kanë të gjitha ligjet për organet...

Mimi Kodheli- Po sikur unë të them, të jetë në Korçë, sepse Korça ka traditë të diasporës.

Vasilika Hysi – Zonja kryetare keni shumë të drejtë, ka shumë vende që i lëvizin selitë sepse janë të gjitha institucionet në Tiranë.

(Ndërhyrje nga më shumë se 2-3 deputetë)

Vasilika Hysi- Vetëm në Shqipëri ndodhen të gjitha në Tiranë.

(Ndërhyrje nga më shumë se 2-3 deputetë).

Mimi Kodheli - Korça është rrethi i parë që me vjen ndër mend, sepse ka një traditë të diasporës...

(Ndërhyrje nga më shumë se 2-3 deputetë)

Apo ta çojmë në Ersekë? Pse duhet të vihet në ligj në Tiranë?

Vasilika Hysi – E kanë marrë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Mimi Kodheli – Nuk e dua në Tiranë, bëje në Durrës, në Shkodër.

Vasilika Hysi – Është për lehtësira me institucionet e tjera.

Mimi Kodheli – Pse e keni lënë në Tiranë? Nuk jam dakord fare.

(Ndërhyrje nga më shumë se 2-3 deputetë)

Vasilika Hysi- Do 3-4 orë për të shkuar.

Mimi Kodheli - Ka *e-mail*-e, ka kompjuterë.

Vasilika Hysi - E heqim fare dhe e vendosim në statut.

“Selia e FSHSZH-së përcaktohet në statutin e saj”.

Mimi Kodheli- Jam kundër këtyre përcaktimeve që të jenë të gjitha në Tiranë. Për shembull të jetë në Shkodër, 1 orë e gjysmë me makinë është.

Klotilda Bushka- Zonja kryetare unë them ta lëmë siç është se personi juridik publik, e ka pavarësinë. Duke qenë se neni 7 i detajon, i bën sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar, jemi në rregull.

Mimi Kodheli - Dakord.

Ervin Bushati - Në pikën më parë ndimore të Shqipërisë, që është Shkodra.

Vasilika Hysi - E kemi ndarë Shqipëria në 4 zona, ta ka bërë planin zonja Eglantina. Në çdo zonë të madhe nga një zhvillim, ndryshe nuk zhvillohet Shqipëria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka - Kjo gjë si ide shpëruese, duhet të ngrihet here pas here.

Mimi Kodheli- Atëherë, neni 4, pika 2 lihet kështu siç është.

Neni 4, pika 3. “Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës e ka selinë të përcaktuar sipas statutit të saj”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 5 “Objektivat e veprimtarisë”. Ka një propozim që fjala “orientim” të zëvendësohet me fjalën “nxitje”. Fjala “orientim” i bie të jetë te neni 5, pika 1. Pra, fondi shërben si mekanizëm i njohur nga ligji për orientimin e prioriteteve filantropike, jo për nxitjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Nxitja është pak më e fortë se orientimi.

Klotilda Bushka – Unë kam një propozim: kur flasim për objektivat, 1-shi dhe 2-shi mund të shkrihen në një. Unë do të sugjeroja që formulimi të bëhej kështu:

FSHZHD-ja është një mekanizëm i njohur nga ligji, i cili...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

FSHZHD-ja, them unë, është një mekanizëm i njohur nga ligji, për nxitjen e prirjeve filantropike dhe investimeve të anëtarëve të diasporës, në përpjekje për zhvillimin social, etj, në Republikën e Shqipërisë, dhe ka këta objektiva. Bëhet një nen.

Pandeli Majko – Po është edhe jashtë saj.

Mimoza Arbi – Po pra, të dyja i vëmë. Unë thjesht po them që 1-shin dhe 2-shin t'i bashkojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Unë kam një pyetje për ministrin, në kuadrin e pikës 2.

Shohim ligjin “Për fondin e diasporës” dhe te ligji që kemi miratuar për diasporën, në Shqipëri, në nenin 22 janë dhënë orientime në lidhje me fushat ku do të punojë diaspora. Thuhet: zhvillimi social, ekonomik e kulturor. Këtu është shtuar edhe zhvillimi rural, te neni 5, pika 2. Kjo bie ndesh me fondin zhvillimit. Prandaj, unë do të sugjeroja të ishte në përputhje me nenin 22 të ligjit “Për diasporën”.

Pandeli Majko – Jam dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – 1-shin dhe 2-shin mendoni t’i lemë në dy paragrafë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kaq? Vetëm: objektivat janë?

Klotilda Bushka – Këto janë rregullime të teknikës legjislative. Dhe do të heqim ruralin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Atëherë, me ndryshimet e propozuara, miratohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ecim. Neni 6.

Besoj se letrën e keni përpara. Pika 3 e nenit 6 të riformulohet si më poshtë: fondi bashkëpunon, për ushtrimin e veprimtarisë së tij, me institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile, të cilat veprojnë në fusha apo sektorë të lidhur me zhvillimin e investimeve në Shqipëri e diasporë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për ushtrimin e veprimtarisë bashkëpunon me institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni dakord me ndryshimet e pikës 3 të nenit 6, ju lutem?

Në rregull.

Pika 4, neni 6 riformulohet: “Këshilli i Ministrave mund të kontraktojë me fondin, sipas marrëveshjeve përkatëse, për menaxhimin e projekteve të financuara prej tij, në përputhje me objektin e veprimtarisë...”

Unë kam një vëzhgim. Këshilli i Ministrave mund të kontraktojë; ia japim ne të drejtën Këshillit të Ministrave të kontraktojë? Ia japim të drejtën fondit të kontraktojë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne i themi Këshillit të Ministrave, që ti kontrakton? Pavarësisht se është ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pandeli Majko – Jo, jo, jo...

Klotilda Bushka – E vendos Këshilli i Ministrave.

Pandeli Majko – Këshilli i Ministrave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – I japim të drejtën Këshillit të Ministrave?

Klotilda Bushka – E ka të drejtën, por ne ia japim të drejtën të kontraktojë me fondin.

Mimi Kodheli – I japim të drejtën Këshillit të Ministrave te ky ligj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse Këshilli e ka të drejtën, nuk ia japim dot me këtë ligj.

Klotilda Bushka – Këtë të drejtë që Këshilli i Ministrave e ka, ne ia japim që ta bëjë edhe me fondin. Sepse i ka të përcaktuara se cilat janë subjektet me të cilat mund të kontraktojë, siç është Fondi i Zhvillimit, agjencitë e ndryshme. Ne këtu i japim të drejtën që, atë të drejtë që ai ka, ta ekzekutojë edhe me fondin.

Adnor Shameti – Të papërcaktuar atje në kompetencat e veta, e identifikojmë këtu si kompetencë në marrëdhënie me fondin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Unë mendoj që fondit i japim të drejtën të kontraktojë me Këshillin e Ministrave, i cili e ka këtë të drejtë me çdo fond që krijohet bazuar në këtë lloj ligji.

Adnor Shameti – Po, por identifikohet marrëdhënia specifike me fondin.

Mimi Kodheli – me këtë ligj ne i japim të drejtën fondit, që të kontraktojë me Këshillin e Ministrave, sepse Këshilli i Ministrave e ka këtë të drejtë apriori për çdo fond që krijohet në këto kushte.

Pandeli Majko – Logjika e lidhjes së kontratave ka të bëjë edhe me vartësinë. Shkon Aliu te mali, jo mali te Aliu. Domethënë, është Këshilli i Ministrave që kontrakton.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund t'i shkojë fondi t'i trokasë Këshillit të Ministrave...

Klotilda Bushka – Shiko, çështja është: kush e ka fondin? Ai që ka fondin do të kontraktojë.

Xhemal Qefalia – Ky është ligj organik, dhe ka të drejtë kryetarja. Duke qenë ligj organik, i jep prioritet. S'i jep dot detyra Kryeministrit.

Mimi Kodheli – Unë kam ligjin për fondin. Fondi i jap ca pavarësi, ca të drejta, i jap edhe të drejtën që të hyjë në marrëdhënie me Këshillin e Ministrave për të marrë projekt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pandeli Majko -Në marrëdhënie me Këshillin e Ministrave, jo me të tjerët.

Klotilda Bushka – Në paragraf thuhet: Në menaxhimin e projekteve të financuara nga Këshilli i Ministrave dhe/ose donatorët në përputhje me objektin e veprimtarisë së këtij fondi, Këshilli i Ministrave mund të kontraktojë me KSHLD-në sipas marrëveshjeve përkatëse”, pra për menaxhimin e projekteve të financuara nga Këshilli i Ministrave.

Pandeli Majko – Është e Komisionit të Ekonomisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – A ta lëmë atë siç ishte?

Mimi Kodheli- Duhet pyetur juristët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli - Unë i jap të drejtën Fondit që të trokasë në derën e Këshillit të Ministrave, i cili e ka atë të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ti i troket në derë Këshillit të Ministrave dhe i thua të të financojë, në parim, jo anasjelltas.

Ervin Bushati –Unë i qëndroj variantit të Komisionit të Ekonomisë.

Vasilika Hysi- Nuk mundet që në këtë projektligj të përcaktojmë detyra për Këshillin e Ministrave. E kundërta duhet të jetë. KQZ-ja mund të marrë fonde nga Këshilli i Ministrave sipas marrëveshjes përkatëse. Ka një ligj për funksionimin e Këshillit të Ministrave.

Pandeli Majko- Unë mendoj ta lëmë si e kanë bërë kolegët e Komisionit të Ekonomisë.

Mimi Kodheli – Jo. Unë mendoj se nuk duhet lënë: “Këshilli i Ministrave mund të kontraktojë”.

Pandeli Majko - Këshilli i Ministrave dhe relatori po propozojnë që të mbetet siç e ka bërë Komisioni i Ekonomisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Bushati -Sipas rregullores, propozimi më i largët është ai që po nxirrni ju.

Mimi Kodheli- Në parim ne në këtë projektligj u japim detyrime dhe të drejta fondeve që do të krijohen. Ligji nuk është për Këshillin e Ministrave. Ai mund të kontraktojë, themi ne te ligji për fondit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pandeli Majko – Ju siguroj që pena e Anastas Angelit dhe Erion Mustafës nuk gabon kollaj.

Ervin Bushati– I ndërrojmë vendet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Evis Kushi – Propozimi i Komisionit të Ekonomisë është më poshtë.

Mimi Kodheli– Ndërkohë që Klotilda pyet ne vazhdojmë me propozimin e Komisionit të Ekonomisë, sipas të cilit “pas pikës 3 të shtohet pika 3.1”. Lexojmë pikën 3: “Fondi bashkëpunon, bashkërendon dhe harmonizon veprimtarinë e institucioneve publike dhe organizmat e tjerë shtetërorë, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë...” A nuk është kjo e njëjtë me pikën 3 të nenit 6?

Dakord, e kemi ndërruar, por do të shtojmë vetëm pikën 3.1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më duhet propozimi i Komisionit të Ekonomisë.

Duhet shënuar që propozimi i Komisionit të Ekonomisë nuk merr në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 9640/2006 për Dhomat e Tregtisë dhe të Industrisë, i ndryshuar, që parashikon vetëm një dhomë industrie.

Atëherë nuk kuptoj një gjë, pas pikës 3 të nenit 6, kur thuhet se Fondi bashkëpunon me struktura dhe institucione publike organizma të shoqërisë civile, të shtohet 3.1 ku thuhet që asiston krijimin e dhomës së biznesit të diasporës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky është ligji nr.9640 për dhomat e tregtisë dhe industrisë, që parashikon vetëm një dhomë tregtie. Si duhet tani?

Mimoza Arbi - Ka dhoma tregtie të tjera, siç është Dhoma Amerikane, por kanë detyrime vullnetare të cilat kanë detyrimin, për mënyrën e taksimit, dhe ...por si dhomë që njihet vetëm një dhomë, e cila ka filialet e veta në të gjithë Shqipërinë, është Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë. Unë nuk e di, por ky është mendimi im nga konstatimet...

Mimi Kodheli – Në rregull...

Klotilda Bushka - ... që i kam bërë ligjit...

Mimi Kodheli – Unë jam dakord me Ninin kur thotë se ti nuk mund të kesh monopole në të pasurin një Dhomë Tregtie dhe të jetë ajo, se bota ka gjithfarë, por për aq kohë sa ligji është këtu ne duhet ta përcaktojmë që Dhoma e Tregtisë duhet të jetë mbi baza....

(Diskutime pa mikrofon)

... ose në bazë të legjislacionit në fuqi, por jo....

Klotilda Bushka – Ministria e do këtë si Dhomë, si mundësi, apo jo?

Mimi Kodheli – Ministria e do si Dhomë, por ligji këtu thotë se ka një Dhomë...

Pandeli Majko – E kemi të shkruar edhe te...

Klotilda Bushka – Ta bëjmë *jumper* se ashtu është edhe në anglisht...

Pandeli Majko – Ajo do të jetë një organizim, siç janë të gjitha organizimet e shtetasve...

Klotilda Bushka – Unë e lexova dje dhe m'u duk sikur ka diçka, prandaj jua sugjerova...

Evis Kushi – Sipas legjislacionit në fuqi mund ta bësh edhe në marrëveshje me Dhomën, sepse a është Dhoma...

Klotilda Bushka – Po u fut ajo aty pastaj te Dhoma e Tregtisë, do ta marrin ata mjeshtrat tanë pastaj dhe...

Evis Kushi– Unë po ju pyes në parim, zoti Majko, pse duhet patjetër Dhomë?

Pandeli Majko – Kjo duhet kështu, sepse këtë e kërkon edhe vetë komuniteti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sepse aty do të mbledhen shtetas nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania, Zvicra deri në Australi, të cilët duan të organizohen dhe të kenë forumet e tyre. Ata e kanë filluar ekzaktësisht këtë, duke bërë aktivitete vjetore, kanë një rrjet të bizneseve, të cilët kanë ardhur edhe këtu, por ne duhet t'u japim...

(Diskutime pa mikrofon)

Klotilda Bushka - Dhomën duan ta hapin këtu në Shqipëri?

Pandeli Majko – Po, por nuk do të asistojnë me para....

Klotilda Bushka – Pra, do ta bëjnë vetë dhe...

Pandeli Majko – ... thjesht me ndihmë juridike...

Elona Hoxha– Po u bë Dhoma e Tregtisë këtu, sipas ligjit për Dhomat e Tregtisë, atëherë dhoma aktuale do ta gllabërojë...

Pandeli Majko – Ata do të kenë një relacion me njëri-tjetrin, siç kanë me Dhomën Amerikane të Tregtisë, siç do të kenë...

Ju lutem, këto gjëra ata do t'i zgjidhin me njëri-tjetrin në bazë të legjislacionit. Ne nuk do të hyjmë tani dhe të rregullojmë se si do të jetë marrëdhënia e Dhomës së Biznesit të Diasporës me Dhomën e Tregtisë, por do të zbatohet legjislacioni në këtë rast...

Evis Kushi – Rasati i vendit e ha atë të huajin, sepse po erdhën këtu këta tanët do t'i marrin...

(Diskutime pa mikrofon)

Pandeli Majko – Ne duam që ata të kenë një zyrë të tyre në ...

(Diskutime pa mikrofon)

– Kështu siç është paraqitur nga Komisioni i Ekonomisë nuk përbën asnjë problem për të qenë pjesë integrale e nenit dhe ne e kalojmë, sepse për ne nuk krijon asnjë lloj problemi, edhe si komision përgjegjës jemi në rregull...

Pandeli Majko – Unë thashë ta kalonit në fund, te nenet tranzitore, sepse në thelb tranzitore është...

Evis Kushi – Nuk ka problem...

Mimi Kodheli – Pra, do ta kalojmë pikën 3 të nenit 6, ku do të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “Fondi asiston krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Më pas...

(Diskutime pa mikrofon)

Adnor Shameti – Unë e mbështes kryetaren, sepse ishte metaforë...

Mimi Kodheli – Patjetër që ishte metaforë, sepse unë e përdor gjithmonë metaforën...

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, kemi miratuar ndryshimet përkatëse nenin 6.

Kush është dakord me nenin 6? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 7.

(Diskutime pa mikrofon)

Kemi lënë të hapur nenin 4, të cilit do t’i rikthehemi prapë.

Evis Kushi – Kisha një pyetje. Ndoshta, kjo mund t’ju duket teknikalitet, por me të vërtetë ma vrasin syrin këto “ja”-të. Për shembull, KM-të për Këshillin e Ministrave si bëhen në ligj KM-ja, ose për Ministrinë e Mbrojtjes, MM-ja?

Mimi Kodheli – Jo, nuk shkruhen kështu, por gjatë...

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – E zgjidhëm se këtë, sepse e ka redaktorja letrare...

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Neni 7.

(Diskutime pa mikrofon)

Evis Kushi – Adnori kishte një propozim....

Adnor Shameti – Procesin e llogaridhënies ta shtrijmë me Diasporën...

(Diskutime pa mikrofon)

A do të votojë edhe diaspora?

Mimi Kodheli – Kë ministër të marrim me vete apo ministrin e Diasporës?

(Diskutime pa mikrofon)

Pandeli Majko – Unë shkova dhe fola me Kryetarin e Kuvendit, i cili më tha se na lejonte, por nuk ju jap asnjë fond...

(Diskutime pa mikrofon)

Shtoni një pikë: “Fondi ndihmon komunikimin e parlamentit me diasporën...”

(Diskutime pa mikrofon)

Adnor Shameti – Dhoma e Diasporës e Italisë ka...

Pandeli Majko – Vizita që kam bërë në Australi ka qenë me sponsorizim, kam udhëtuar me ekonomi dhe vizita e fundit që kam bërë në Itali ka qenë me paratë e mia...

Mimi Kodheli – Po mirë, kanë paguar taksapaguesit sa të paguash një biletë tjetër....

(Diskutime pa mikrofon)

Pandeli Majko – A mund të vazhdojmë?

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Vazhdojmë!

Kapitali dhe burimet e financimit.

Të ardhurat në buxhetin e fondit krijohen nga:

a) Fonde të përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, donatorëve të ndryshëm për financimin e projekteve të zbatuara nga fondi.

b) Fondet nga buxheti i shtetit. Germa “b”, Komisioni i Ekonomisë sugjeron: nga “fondet nga buxheti i shtetit” të bëhet “fondet nga buxheti i shtetit për projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave, sipas pikës 4 të nenit 6 të këtij ligji”.

Klotilda Bushka - Pse nuk e bëjmë germën “b” kështu: “fondet nga buxheti i shtetit për projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave, sipas parashikimeve të këtij ligji”?

Mimi Kodheli – Jemi dakord!

Vijmë te pika 2, komentet e Komisionit të Ekonomisë. Fondi i përdor të ardhurat e krijuara për financimin e veprimtarive të veta, sipas procedurave të përcaktuara në statut.

Komisioni i Ekonomisë kërkon që pika 2 të formulohet si më poshtë: “Fondi i përdor të ardhurat e krijuara për financimin e veprimtarive të veta sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar”.

Së dyti, komisioni sugjeron që në fund të nenit 7, të shtohet edhe pika 3, me këtë përmbajtje: “Fondi zbaton të gjitha rregullat e legjislacionit e menaxhimit financiar dhe kontrollin, rregullat dhe procedurat e hollësishme për administrimin e....”

(Diskutim pa mikrofon)

Jeni dakord me ndryshimet që vijnë nga propozimet e Komisionit të Ekonomisë për nenin 7? Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet neni 7.

Neni 8 “Organet drejtuese”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 9 “Përbërja e këshillit drejtues”.

Kemi bërë një diskutim të gjatë për këtë nen dhe besoj se nuk ka asnjë propozim për ndryshim.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Adnor Shameti - Zonja kryetare, më falni! Doja të bëja një ndërhyrje te neni 9.

Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillit është 4-vjeçar me të drejtë ripërsëritje, apo nuk ka të drejtë?

(Diskutim i disa personave njëherësh)

Mimi Kodheli – Atëherë, në pikën 4 të nenit 9 “Përbërja e këshillit drejtues”, “Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues është 4 vjet me të drejtë rizgjedhje”.

Neni 10.

Propozimi nga Komisioni i Ekonomisë sugjeron që në projektligj të shtohen dispozita që lidhen me raportimin për veprimtarinë e fondit, të cilat mungojnë. Shtesat që propozohen, janë si më poshtë:

Për nenin 10, në pikën 1...

(Diskutim i disa personave njëherësh)

Vasilika Hysi – Lidhur me shkronjën “e”, kam një problem: nuk mundet këshilli drejtues të miratojë kushtet dhe kriteret e marrëdhënies së punësimit. Duhet ta ndajmë mendjen, punonjësit duhet të punojnë në fond. Do të jenë punonjës, marrëdhëniet e të cilëve do të rregullohen me Kodin e Punës, apo me shërbimin civil? Në qoftë se rregullohen me Kodin e Punës, këshilli drejtues nuk ka punë.

Mimi Kodheli – Jam plotësisht dakord me Vasilikën!

Në gjykimin tim, germa “e”, thotë: “Marrëdhëniet e punësimit në Fond rregullohen nga Kodi i Punës sipas legjislacionit në fuqi”.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për financierët.

(Diskutim pa mikrofon)

Ilda, më fal, këto janë kompetencat e këshillit. Këshilli nuk mund të përcaktojë kriteret dhe kushtet e marrjes në punë, domethënë të marrëdhënies së punës.

E dyta, që do të diskutohet, është kategoria e nivelit të pagave. A do të caktohet me VKM apo me statut? Këto gjera duhen përcaktuar, duhen thënë.

Klotilda Bushka – Njëra çështje është çfarë statusi kanë këta, dhe po themi që do të jenë me kod pune, dhe tjetra, pavarësisht se janë me kod pune, duhet të kenë një nivel pagash.

Vasilika Hysi – Kush do t'i përcaktojë këto?

Klotilda Bushka – Këshilli Mbikëqyrës.

Vasilika Hysi – Atëherë do të themi: miraton kategorinë e nivelit të pagave”. Kush e propozon nivelin e pagave?

Klotilda Bushka – Drejtori e propozon.

Vasilika Hysi – Po këto duhen rregulluar me ligj, nuk mund të lihen kështu.

Klotilda Bushka – “...miraton strukturën, kushtet dhe kriteret bazë të marrëdhënieve të punësimit dhe kategorinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për nivelin e pagave...”, në rregull është, sigurisht që diku do të referohet. “Miraton bilancin, analizon raport-kontrollin...” në rregull është, do të shtojmë vetëm që do të jetë me marrëdhënie pune.

Moza, e ke shkruar diku, se edhe unë e lexova.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka te neni 13. “Marrëdhëniet e punës të punonjësve të kësaj administrate rregullohen sipas Kodit të Punës”.

Mimi Kodheli – Riformulimi do të rrijë siç është. Germa “i” thotë: “Raporton në mënyrë periodike pranë Ministrisë përgjegjëse për Diasporën”, kjo është shtesa që propozohet. Çfarë do të thotë “në mënyrë periodike”?

Adnor Shameti – E kemi në dy formate, vjetore dhe periodike. A e mban mend, Vasilika?

Vasilika Hysi – Një raport vjetor do ta bëjë se s'bën.

Pandeli Majko – Në fakt, u thashë atyre që të shtonin edhe nënkomisionin në Kuvend.

Adnor Shameti – E kemi te 13-ta.

Mimi Kodheli – Unë jam dakord që të shtohet germa “i” “raporton në mënyrë periodike”.

Adnor Shameti – E kemi te 13-ta këtë, se e ka sugjeruar Komisioni i Ekonomisë.

Mimi Kodheli – Komisioni i Ekonomisë ka propozuar që në nenin 10 të shkruhet kjo përmbajtje: “Raporton në mënyrë periodike pranë Ministrisë përgjegjëse për Diasporën”

Pandeli Majko – E ka përsëritur.

Klotilda Bushka – Ose do ta lëmë te 10-ta ose te 13-ta.

Mimi Kodheli – Kush është dakord me komentet dhe vëzhgimet te neni 13?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 11.

Komisioni i Ekonomisë për germën “b” të pikës 1 ka një propozim: sugjeron që, për të harmonizuar kërkesat për zgjedhjen e drejtorit ekzekutiv me statusin e fondit, si person juridik, në nenin 11 germa “b” e pikës 2 të riformulohet si më poshtë: “të ketë mbaruar arsimin e lartë në shkencat ekonomike të administrimit publik ose juridik”.

Elona Hoxha– Ai mund të jetë edhe për marrëdhëniet ndërkombëtare, mund të ketë mbaruar për Shkenca Politike? Është shumë e ngushtuar.

Mimi Kodheli – Unë nuk jam dakord në këtë gjë. Pse duhet të ketë mbaruar arsim të lartë ky? Çfarë quani “arsim të lartë”?

Vasilika Hysi – E kemi riformuluar këtë.

Adnor Shameti – E kemi formuluar “Ciklin e dytë të studimeve”, e kemi rregulluar.

Vasilika Hysi –Kjo është riformuluar, pra të ketë mbaruar ciklin e dytë të studimeve universitare në Shkencat Ekonomike, nuk kemi rënë dakord me formulimin e germës “b”.

Mimi Kodheli – Gabimi që ne bëjmë është që ne i përcaktojmë...

Klotilda Bushka – Këtë doja të thosha, pse i kemi detajuar kaq shumë?

Vasilika Hysi – Nuk mund të fillojë një agronom punë, si në rastin kur kemi çuar te AKBN-ja një artiste këngëtare.

Elona Hoxha – Po pse duhet paragjykuar? Për shembull unë kam mbaruar për biologji dhe kam qene zëvendësministre e Brendshme. A ka ndonjë gjë të keqe këtu?

Vasilika Hysi – Ke qenë person politik.

Evis Kushi – Dakord por një tjetër mund të thotë që ti nuk bën aty.

Vasilika Hysi – Hiqeni “juridik ose ekonomik” dhe vëre “drejtues fondi”, se do të menaxhojë paratë.

Mimi Kodheli – Ka njerëz që kanë mbaruar agronomi dhe kanë menaxhuar milionat e Europës nëpër projekte të fondeve.

Vasilika Hysi – Më fal, kur thuhet Shkencat Ekonomike aty ke ekonomik, menaxhim biznesi, financë, bankë, pra ke shumë.

(Diskutime pa mikrofon)

Pandeli Majko – Po ju sjell një shembull. Motra e shoqes që kam në krah, ma përmendi vetë drejtoresha e bankës që ishte këtu... Vetëm se nuk pranoi, se ishte tek ujësjellësi i Tiranës. Unë u çudita, se thashë, inxhinier hidroteknik dhe menaxhim projektesh janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme.

Evis Kushi – Inxhinieri është i mirë.

Pandeli Majko – Jo, e kam fjalën në konceptin e procesit të menaxhimit të projekteve.

Evis Kushi – Nuk mund të jetë inxhinieri drejtor këtu? Bëhet drejtor dhe e qan inxhinieri!

Vasilika Hysi – Sepse lidhet me investimet.

Klotilda Bushka – Shumë bukur. Është atëherë.

Vasilika Hysi - Por ky fond është arsim, kulturë dhe...

Klotilda Bushka – Ai do të ketë ekspertë të fushave aty, do të ketë një...

Evis Kushi– Do të ketë një sistem filtrimi. Nuk ia vlen të futemi në kaq...

Mimi Kodheli – ...definicionin e arsimit të lartë dhe kaq.

Vasilika Hysi – Arsim i lartë është edhe *bachelor*-i, Mimi. Prandaj duhet thënë të ketë përfunduar edhe ciklin e dytë të studimeve universitare. Nuk do të fusim me 3-vjeçarin...

(Diskutime pa mikrofon)

Me Bolonjën e kemi bërë ne.

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Pra, ciklin e dytë të studimeve universitare.

Klotilda Bushka – Pa përcaktuar fushën.

Klotilda Bushka – Germën “c” do ta heqim fare: “Preferohen kandidatë që kanë kualifikime shtesë”. Kjo nuk është në dorë të punësimit me ligj...

Pra, Moza, hiqet “c”-ja, hiqet juridiku dhe ekonomiku. Të tjerat janë në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kthemi pak te 6/4 se më erdhi një formulim.

Mimi Kodheli – Prit sa të mbarojmë këtë, të lutem!

Do të heqim edhe germën “ç”: “Ka përvojë pune prej jo më pak se 3 vjetësh në menaxhimin e projektit të financuar nga partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.” Do ta heqim?

Vasilika Hysi – Këtë e shtuam ne, me mendimin që të mos jetë kusht selektiv, por të jetë një bonus më shumë. Midis dy kandidatëve që kanë vlerësim të njëjtë...

Klotilda Bushka – Ndoshta të mos përcaktohet... Të ketë 3 vjet eksperiencë, dakord, por...

Vasilika Hysi – 3 vjet patjetër, se flitet për drejtor këtu.

Klotilda Bushka – Po pra, prandaj po them.

Mimi Kodheli – Ligjet (unë kam si *outsider* këtë përcaktim) më të mira në botë janë ligjet më të shkurtra, më të thjeshta.

Vasilika Hysi – Të jep hapësirë të futësh këdo pastaj.

Mimi Kodheli – Sepse ti ke akte nënligjore, që rregullojnë të gjitha... Pra, sa më pak të fusim “duhet ta ketë ngjyrën e syve kështu” në ligj, aq më shumë japim hapësirë për t’u zgjedhur kur të vijnë aktet nënligjore...

Klotilda Bushka – Edhe për të qenë konform ligjit.

Mimi Kodheli – T’i heqim këto “jo këtu e jo atje”, “ta ketë hapin e madh apo ta ketë hapin e vogël.”

Klotilda Bushka – Thjesht të ketë 3 vjet eksperiencë pune, kaq.

Vasilika Hysi – “Jo më pak se”, janë terma juridike.

Klotilda Bushka – Po pra, jo më pak e 3 vjet.

Vasilika Hysi – Për pikën 3, “Afati i qëndrimit në detyrë të drejtorit ekzekutiv është 5 vjet me të drejtë rizgjedhjeje”, kam një riformulim: “Drejtori ekzekutiv zgjidhet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.”

Klotilda Bushka – Dakord.

Ervin Bushati – Sa herë?

Vasilika Hysi - 1 herë, 2 herë, varet... Atë duhet ta përcaktojë vullneti i propozuesit.

Klotilda Bushka – Një herë bollë e ka, them unë.

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Si do ta bëjmë? Me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se 1 herë?

(Diskutime pa mikrofon)

Ervin Bushati – Çfarë vizioni mund të ketë në 10 vjet ai?

(Diskutime pa mikrofon)

Adnor Shameti– Me të drejtë rizgjedhjeje dhe pikë, se po të jetë qeveria aq gjatë, domethënë do ta mbajë prapë. Po ndryshoi qeveria, do ta ndryshojë.

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Propozimet e fundit. Në fund të germës “d” të shtohet shprehja “të vendeve anëtarë të BE-së.”

Vasilika Hysi – Unë kam propozuar diçka tjetër. Nuk mund të zgjidhet drejtor ekzekutiv një person, i cili është hequr nga një pozicion tjetër për shkelje disiplinore, për keqmenaxhim të fondeve, të burimeve e të tjerë.

(Diskutime pa mikrofon)

Pandeli Majko – Për shkelje, që është larguar për shkelje.

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Unë nuk po them masë disiplinore. Të mos rekrutohet në qoftë se...

Klotilda Bushka – E kanë ligjet e tjera, që drejtori...?

Vasilika Hysi – Aty ku menaxhohen burime financiare, ti nuk mund të marrësh në punë dikë që është hequr për shkelje financiare nga ministria...

Klotilda Bushka – Kjo mbetet në integritetin e atyre që e votojnë pastaj...

Evis Kushi – A do të marrë ai një vërtetim nga prokuroria, nga gjykata...?

Vasilika Hysi – Thashë masë disiplinore, jo penale.

(Diskutime pa mikrofon)

Evis Kushi – A thamë të ketë sa më pak gjëra ligji?

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Neni 11.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 11 me ndryshime.

Neni 12...

Klotilda Bushka – Pa shkuar te neni 12, a ta mbarojmë pikën 4 të nenit 6?

Mimi Kodheli – Po, patjetër. Kështu e lamë.

(Diskutime pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Dëgjojeni pak riformulimin: “FSHZHD-ja menaxhon projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave dhe/ose nga donatorët në përputhje me objektin e veprimtarisë së Fondit, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse”. Nuk është pjesa që Këshilli i Ministrave kontraktton apo Fondi kontraktton.

(Diskutime pa mikrofon.)

Mimi Kodheli – Shumë mirë është.

Jeni dakord?

Person – Dakord.

Mimi Kodheli – U mbyll neni.

Bravo, Klotilda!

Miratohet.

Evis Kushi – Si e ke zgjedhur këtë komision, shefe!

(Diskutime pa mikrofon.)

Mimi Kodheli – Pika 1 e nenit 12 të riformulohet si më poshtë:

“Drejtori ekzekutiv ushtron këto kompetenca”. Më pas kemi kompetencat. Ka një propozim që germa “a” e pikës 1 të riformulohet si më poshtë: nga “është përfaqësues ligjor i fondit”, të bëhet “përfaqëson Fondin në marrëdhënie me të tretët brenda dhe jashtë vendit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është më e saktë.

Jeni dakord?

Në fund të germës “d”, që thotë: “Zgjedh dhe emëron personelin në përputhje me procedurat e konkurrimit të hapur”, të shtohet fjalia “në përputhje me Kodin e Punës”. Unë jam plotësisht dakord.

Jeni dakord?

Elona Hoxha – Mund të bëj një pyetje?

Mimi Kodheli – Po.

Elona Hoxha – Do të ketë statut kjo?

Mimi Kodheli – Po, patjetër.

Elona Hoxha – Atëherë, kompetencat e drejtorit pse duhet të jenë këtu, kur janë të përcaktuara në statut?

Vasilika Hysi - E thotë pika 2.

Themi: “Administron burimet financiare të fondit në përputhje me këtë ligj dhe statut”. Jo, janë edhe fondet për menaxhimin e buxhetit. “Administron burimet financiare në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj dhe në statut”.

Klotilda Bushka – Është në rregull, sepse në ligj thuhej se do ta zbatojë sipas ...

Vasilika Hysi – Tani po e kap veshin nga larg.

Mimi Kodheli – Nastradin, ku e ke veshin, domethënë.

Klotilda Bushka – Je dakord ta shtojmë, sipas legjislacionit në fuqi?

Vasilika Hysi - Po, për menaxhimin financiar dhe

(Diskutime pa mikrofon.)

Fondi dhe buxheti menaxhohen.

Elona Hoxha – A thuhet këtu “mënyra dhe procedura e ushtrimit të kompetencave të drejtorit përcaktohen në statut”?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këto që themi ne më lart, nuk janë kompetenca?

Vasilika Hysi – Është menaxhimi i burimeve financiare.

(Diskutime pa mikrofon.)

Elona Hoxha – Ky administron fondet, sipas këtij ligji, dhe statutet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Mimi Kodheli – Mund t'i quajmë dy mbledhje.

Xhemal Qefalia – Ne jemi mbledhur edhe dje.

Mimi Kodheli – Ky është penalizmi, meqenëse nuk ishim dje.

Vasilika Hysi – Ne kemi pritur 1 orë dje.

Ervin Bushati – Kjo është arsyeja pse po flasim kaq shumë.

Mimi Kodheli – Vazhdojmë.

Persone – E miratuam nenin 12?

Mimi Kodheli – Po, e miratua nenin 12 me ndryshimet përkatëse, qoftë në marrëdhënie me të tretët, edhe për fjalinë “në përputhje me Kodin e Punës”.

Shtohet si nen më vete neni 13/1.

Adnor Shameti – Raporti periodik.

Mimi Kodheli – Pra, lexohet çfarë shtohet nga propozimi që vjen nga Komisioni i Ekonomisë.

Raportimi: “Fondi raporton për veprimtarinë vjetore dhe periodike të institucionit pranë Ministrisë përgjegjëse për Diasporën”.

“Fondi raporton për fondet e mbledhura dhe mënyrën e shpenzimit të tyre pranë Nënkomisionit për Diasporën dhe Emigracionin në Kuvendin e Shqipërisë, sipas kërkesës së tij”.

(Diskutime pa mikrofon.)

E lëmë: “me kërkesë të tij”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Me kaq mbyllen propozimet e nenit 13 dhe të nenit 13/1, që do të bëhet 14 në zbardhje.

Jeni dakord me nenin 13/1, që të kthehet në nen 14 në zbardhje? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Neni 14, i cili do të kthehet në nenin 15 në zbardhje, riformulohet si më poshtë: “Gjatë veprimtarisë së tyre punonjësit e Fondit parandalojnë dhe shmangin konfliktin e interesave sipas legjislacionit në fuqi “Për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi...”.

Çfarë do të thotë “e parandalon dhe e shmang”?

Klotilda Bushka– Të miratohen rregullat për shmangien dhe parandalimin e konfliktit të interesave sipas legjislacionit në fuqi.

Evis Kushi – Nuk është e detyrueshme kjo edhe pa qenë këtu në ligj?

Adnor Shameti – Është gjuha që ka ligji për konfliktin e interesave.

Evis Kushi – Te ligji i konfliktit të interesit nuk thuhet se në cilat institucione aplikohet?

Adnor Shameti – Do ta kalojmë me riformulim.

Mimi Kodheli – Kush është dakord me riformulimin e riformulimit?

Faleminderit!

Pra, neni 14, të cilin e zbardhëm, do të jetë neni 15.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me ndryshimin.

Faleminderit!

Neni 15 “Krijimi i organeve të para drejtuese” dhe neni 16 “Financimi i FSHZHD-së për vitin e parë” sugjerohet të bashkohen në një dispozitë të vetme kalimtare, me të njëjtën përmbajtje dhe do të jetë bëhet neni 17.

(Diskutime pa mikrofon.)

Pra, neni 16 bie për shkak se FSHZHD-ja nuk do të financohet nga buxheti i shtetit vetëm në vitin e parë të krijimit, por do t’i referohet financimit, sipas ndryshimeve që pëson ligji. Neni 15 do të kalojë në nenin 16 dhe do të vazhdojë të mbetet “Dispozitë kalimtare”.

Vasilika Hysi – Zonja kryetare, unë kam një pyetje.

Ne kemi thënë se ligji hyn në fuqi brenda 15 ditëve dhe brenda 3 muajve duhen bërë aktet nënligjore, sepse pa bërë aktet nënligjore këshilli drejtues dhe drejtori nuk mund të zgjidhen jo më vonë se 3 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit. Pra, gjëja e parë që duhet bërë janë aktet nënligjore.

Aktet nënligjore bëhen 3 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit. Në një nen të projektligjit ju thoni: “Jo më vonë se 3 muaj nga data e hyrjes në fuqi të ligjit zgjidhet këshilli drejtues dhe drejtori” dhe më pas “jo më vonë se 3 muaj nga data e krijimit të këshillit miratohet statuti”. Tani, drejtori i këshillit zgjidhet pas miratimit të statutit dhe manualit, pra pasi janë bërë aktet nënligjore?

(Diskutime pa mikrofon.)

Mimi Kodheli – Pra, ta lemë “jo më vonë se 6 muaj”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Pra, neni 15 që do të zbardhet si neni 16 “Krijimi i organeve të para drejtuese” do të formulohet: “Këshilli drejtues dhe drejtori ekzekutiv i FSHZHD-së emërohen jo më vonë se 3 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

“Statuti dhe manuali i procedurave miratohen nga këshilli drejtues i FSHZHD-së, jo më vonë se 3 muaj nga data e krijimit të këtij këshilli”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – A mund të fusim një fjali, që në përzgjedhjen e stafit të mbahet sa është e mundur barazia gjinore?

(Diskutime pa mikrofon.)

Mimi Kodheli - Atëherë, ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të pikës 3, të nenit 9, të këtij ligji.

“Hyrja në fuqi”, “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Miratohen.

Hedhim në votim në tërësi ligjin.

Pro? Kundër Abstenim?

Miratohet.

Ministri ka diçka të fundit për të thënë.

Pandeli Majko – Pothuajse të gjithë legjislacionin të dhoma e diasporës ne e kemi kaluar me logo. Kini parasysh se logot janë shumë specifike dhe bëhet fjalë për biznesin, ndaj sugjeroj që të mos vendosin logo të çuditshme. Kjo bëhet vetëm për ta bashkëngjitur logon të Dhoma e Biznesit dhe të mos vendosin logo të çuditshme.

(Diskutime pa mikrofon.)

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare
Elona Hoxha

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Ina Jano

